

**SPOKEN ALBANIAN ON PUBLIC TELEVISION OF KOSOVO AFTER
THE LANGUAGE CONSULTATION OF PRISTINA AND IN THE
PRESENT DAYS**

**SHQIPJA E FOLUR NË TELEVISIONIN PUBLIK TË KOSOVËS PAS
KONSULTËS GJUHËSORE TË PRISHTINËS DHE NË DITËT E
SOTME**

Albulena ALIDEMA¹

¹ *Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Education, University of Prizren "Ukshin Hoti"*

^{*} *Corresponding author e-mail: albulena.alidema@uni-prizren.com*

Gjuha shqipe në televizion, në Kosovë, ka filluar së përdoruri me themelimin e Televizionit të Prishtinës (1975) dhe transmetimit të programeve në gjuhën shqipe, që kishin filluar në kuadër të Televizionit të Beogradit, në vitin 1966. Megjithatë, para se të fillonte të punonte Televizioni i Prishtinës, ishte një medium tjetër, që transmetonte program në gjuhën shqipe, bëhet fjalë për Radio Prishtinën. Historiku i këtij mediumi, është dukshëm më i hershëm sesa i televizionit. Radio Prishtina filloi punë menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, më 1945, në Prizren, pastaj u transferua në Prishtinë, për të vazhduar transmetimin deri në vitin '90, kur u ndalua nga pushteti serb.

Siç rezulton, transmetimi në radio i emisioneve në gjuhën shqipe, në Kosovë, është bërë rreth tri dekada para standardizimit të gjuhës shqipe, ndërsa në televizion tri vjet pas Kongresit të Drejtshkrimit. Në vijim, të këtij punimi, jemi munduar që të bëjmë një analizë krahasimtare të përdorimit të gjuhës shqipe në radio dhe televizion, para dhe pas gjuhës standarde, duke marrë si shembuj krahasues kronikat në TVP, në atë kohë dhe atyre që transmetohen sot, si dhe një shembull ilustrativ, të përdorimit të gjuhës shqipe, në Radio Prishtinën e atyre viteve të para standardit. Tashmë është e ditur se përpjekja për përvetësimin e një standardi gjuhësor, në Kosovë, të ngjashëm me atë që përdorej në Shqipëri, u bë disa vite përpara Konsultës Gjuhësore të Prishtinës (1968) dhe Kongresit të Drejtshkrimit (1972).

Kjo përpjekje, më shumë se obligim zyrtar, ishte përgjegjësi individuale e intelektualëve të kohës dhe institucioneve të rëndësisë së veçantë, në këtë rast, siç është edhe televizioni, që të përdorej një gjuhë shqipe sa më e standardizuar, si shembull, jo vetëm i përdorimit të drejtë, po edhe të pastër të gjuhës shqipe. Funkzioni i kësaj përpjekjeje këndvështrohej në kuadër të aspiratës së përgjithshme të asaj kohe, të dekadave të mëhershme e të mëvonshme, për një gjuhë shqipe standarde, të njësuar për të gjithë shqiptarët kudo që jetojnë.

Pra, në Kosovë, mediumet audiovizive janë përdorur në shërbim të përpjekjes së vazhduar për përvetësimin e një forme të gjuhës së njësuar shqipe edhe para normimit të saj në Kongresin e Drejtshkrimit, që vite më vonë i hapi rrugë përdorimit detyrues të standardit gjuhësor, jo vetëm në mediat e shkruara dhe elektronike, por edhe në administratë e tekste mësimore, në të gjitha nivelet e edukimit etj. Konsulta Gjuhësore e Prishtinës i ka paraprirë Kongresit të Drejtshkrimit, prandaj ka qenë afërmendsh, që përveç në mediumet audiovizive në Kosovë, standardi gjuhësor, në një masë dhe në disa raste, të shtrihet me përdorimin e tij edhe në shfaqjet teatrale dhe filmat e realizuar në Kosovë, veçanërisht, në fundvitet '60 dhe në fillimvitet '70.

Studiuesit e historisë së gjuhës, shumë prej tyre pjesëmarrës të drejtpërdrejtë të Kongresit të Drejtshkrimit, e lidhin këtë përpjekje për përdorimin e standardit gjuhësor, me qëllimin e përbashkët të identifikimit dhe unifikimit kombëtar. Në krye të kësaj përpjekjeje, gjithmonë është vënë shtresa intelektuale, akademike, zyrtare, etj., pa ndonjë detyrim të veçantë, por më shumë si obligim personal për kontribut në emancipimin, formësimin dhe zhvillimin e përgjithshëm kombëtar.

Prandaj, parë në kontekstin e zhvillimit historik, të procesit të njësimin të gjuhës shqipe, do thënë, se Kongresi i Drejtshkrimit, e dëndësoi dhe e ngjeshi indin e përbashkët kulturor kombëtar, e ngriti kërkesën e kulturës gjuhësore në lartësinë e kërkesave intelektuale të një shoqërie moderne, e shtoi kujdesin shoqëror për pastërtinë dhe pasurimin e gjuhës, dëshmoi para botës njësinë etnike, gjuhësore dhe kulturore të shqiptarëve, në gjithë hapësirën e tyre të banimit, pavarësisht nga kufijtë shtetërorë, e lartoi prestigjin e gjuhësisë shqiptare në vendet përkatëse dhe në rrethet shkencore në botë. Për këtë, ajo ngjarje meriton nderimin tonë të përhershëm (Lafe, 2014: 48-49).

Por, si është përdorur gjuha shqipe në televizion, në Kosovë, para zyrtarizimit të standardit të saj, në Kongresin e Drejtshkrimit dhe si përdoret sot, shumë dekada më vonë, do ta kuptojmë në shembujt e mëposhtëm ilustrativë dhe krahasimtarë. Siç është thënë edhe më sipër, shqipja standarde filloi të përdorej edhe para Kongresit të Drejtshkrimit, që pas Konsultës Gjuhësore të Prishtinës, e cila mund të themi se i dha një vulë përfundimtare gjuhës standarde, të kristalizuar më vonë në Kongresin e Drejtshkrimit. Që nga ajo kohë, intelektualët në Kosovë, filluan përdorimin e gjuhës së njësuar, jo pse ishin të obliguar nga ndokush, por i dhanë vetes detyrë për njësimin e shqipes standarde, një reflektim i tillë u vërejt edhe në përdorimin e gjuhës në televizionin publik, (TVP), i cili, që në vitet '70 (pas Konsultës Gjuhësore të Prishtinës), kur edhe filloi programin e tij, me pak orë pune, i dha vetes detyrim për përdorimin e gjuhës standarde shqipe.

Në emisionet e monitoruara, të nxjerra nga arkivi i RTP, (gjatë viteve '70), kemi vërejtur përdorimin e gjuhës standarde, me një kujdes të shtuar, me një diksion të pasur, me ritëm dhe tempo të duhur, mirëpo, një gjë e tillë, nuk është parë sot, pesëdhjetë vjet pas Kongresit të Drejtshkrimit. Kur jemi te gjuha e folur, në mediat audiovizive në Kosovë, duhet përmendur faktin se, për dallim prej kohëve të sotme, në vitet '60 dhe '70, të shekullit 20, folësit në radio dhe televizion në Kosovë, trajnoheshin me muaj të tërë për përdorim sa më të mirë, jo vetëm teknik, por edhe gjuhësor, në radio dhe televizion. Këtë gjë e konfirmon, në një intervistë të tij, edhe ish folësi shumëvjeçar i Radio Kosovës, Shaban Arifaj, i cili mes tjerash kujton se:

“Konkursi për folës ka qenë gjithmonë i hapur. Unë isha në vitin e tretë të studimeve në Fakultetin Filozofik dhe erdhën atje me një teknik dhe një gazetar Bexhet Baraliu, na provuan zërin, na dhanë nga një lajm kështu të shkruar me makinë shkrimi atëherë edhe e lexuam, bënë një përzgjedhje. Por, është interesant ta them, do të bëj një krahasim me folësit dhe gazetarinë e sotme: nja gjashtë muaj unë s'kam parë studio drejtpërdrejt, vetëm ushtrime, gjashtë muaj rresht, me folës, me gazetarë, me redaktorë, me këshilltarë gjuhësorë me të gjithë kemi punuar gjashtë muaj. Pas gjashtë muajsh, kam lexuar edicionin e parë informativ në orën 14, 2 minuta, me katër kartela, ose me katër lajme të shkurta nga bota” (Arifaj, 2018, intervistë).

Kur jemi te gjuha e përdorur në radio dhe televizion, do thënë se një ndihmesë e madhe profesionale, për radion dhe televizionin e Prishtinës, është dhënë edhe nga njerëzit e teatrit të Prishtinës, të cilët ishin më të trajnuar dhe më me përvojë në përdorimin më të pastër të gjuhës shqipe, në atë kohë. Aktorët e trupës rezidente të Teatrit Popullor Krahinor (Sot Teatri Kombëtar i Kosovës), u angazhuan në shumë emisione, në radio dhe televizion. Në një krahasim të një interviste, të një aktori të njohur të asaj kohe (viti 1970), pa shkollim superior dhe një aktori të kohës së sotme, me shkollim superior, vërehet dallim i madh në përdorimin e gjuhës standarde, gjatë intervistës në TV.

Shembulli i mëposhtëm është transkriptim origjinal i intervistës së dhënë nga aktori Abdurrahman Shala për TVP, në vitin 1970: *“Në radio, në Radio Prishtina, në vitin 1951 kam ardhur si gazetar. Por nuk qëndrova shumë në radio Prishtina. Para se të vija në Radio Prishtinë, isha në Teatër Krahinor, si aktor. U largova prej teatri, siç ju thashë, hyra në punë në Radio Prishtinë, si gazetar, kam qenë si spiker, tanë teknologjinë në radio stacion, në atë kohë e kam përcjellë, mirëpo edhe aty nuk muna me qëndru shumë, prapë u ktheva në teatër. Në atë kohë, derisa isha në Radio Prishtinë nja gjysmë vjeti, siç thashë njëkohësisht kam qenë spiker dhe gazetar. Më vonë, kur u largova, kontaktet dhe lidhjet me Radio Prishtinën, gjithnjë i kam pasur në mënyrë kontinuale dhe bashkëpunimi im me Radio Prishtinën vazhdoi si aktor i teatrit të Prishtinës dhe regjisor i dramës shqipe. Paralelisht, aktiviteti im në teatër ka qenë plotësuar edhe me Radio Prishtinën, Radio dramat e para, humoreskat...”*

Ndërsa, krahas fragmentit të intervistës së aktorit, në vitin 1970, si shembull ilustrues, po shkëpusin një bashkëbisedim dinamik, në Televizionin Publik (RTK), realizuar në vitin 2016. ndërmjet dy aktorëve të njohur të teatrit dhe filmit, por me këtë rast, në role të ndryshme, njëri si moderator në TV e tjetri si mysafir, pra, i intervistuar. Që të dy janë me përgatitje shkollore superiore, madje i intervistuari është edhe mësimdhënës në Fakultetin e Arteve në Prishtinë:

MODERATORI: Ku je loçkë? Çka ka?

MUSAFIRI: A me t’thirrë Buf a Fatmir?

MODERATORI: Qysh ty t’vjen ma kah lukthi.

MUSAFIRI: Ok, po.

MODERATORI: Edhe un ty po t’thirri Kabi.

MUSAFIRI: “Osht interesant se qe 20 vjet bahet gati para kamerave edhe gati po m’teret goja...”

MODERATORI: T’teret goja. Uj kem sa t’dush. Syzat po t’rrinë mirë.

MUSAFIRI: Faleminderit shumë.

MODERATORI: Ta ka ndrru imazhin krejt.

MUSAFIRI: Doktorri mi ka zgjedh.

MODERATORI: S’jon për shmek a?

MUSAFIRI: U dasht. Ma n’fund.

Nga dy shembujt e mësipërmë, vërejmë dallim të madh, në përdorimin e gjuhës shqipe, në televizionin publik, në një distancë pesëdhjetë vjeçare. Shembulli i parë dëshmon për përpjekjen e vazhdueshme për përdorimin e gjuhës standarde shqipe edhe para se ajo të normohej zyrtarisht, ndërsa shembulli i dytë, është një nga shembujt e shumtë, që dëshmon, se përdorimi i gjuhës shqipe, nga folësit në televizion, nuk ndjek linjën e standardit dhe, çdo ditë e më shumë, ka degraduar.

Në një paralele krahasimi, e njëjta gjë vlen edhe për folësit e kategorive të tjera sociale, të cilët, shumë më shumë, kanë bërë përpjekje për përdorim të standardit gjuhësor, në TV, para pesëdhjetë vjetësh, se sa që bëjnë sot. Për shembull krahasimi, kemi marrë dy kronika (reportazhe) televizive, me një distancë kohore, prej gati pesëdhjetë vjetësh, të realizimit dhe transmetimit të tyre. Kronika e parë ka të bëjë me Besëlidhjen e Rugovës dhe është realizuar e transmetuar në TVP, në vitin 1970, pra, pas Konsultës së Prishtinës dhe para Kongresit të Drejtshkrimit.

Ky reportazh bën fjalë për një tubim në Malësinë e Rugovës, si zonë e thellë në perëndim të Kosovës, që është quajtur Lidhja e Rugovës. Nga kjo kronikë, janë shkëputur fragmente të narracionit të gazetarit (*autorit të kronikës televizive*) si dhe thekse nga dy folës, malësorë të asaj kohe: Gazetari (*autori i kronikës*), në cilësinë e narratorit, bën një përshkrim interesant të ambientit të Rugovës, si dhe rëndësisë që ka kjo ngjarje. Ky përshkrim i tij bëhet me një gjuhë të pastër dhe të pasur, si dhe me shumë pak shmangie ortoepike nga standardi gjuhësor:

NARRATORI: *“Majat i ka mbuluar dëbora...Kanë zbardhuar malet e Rugovës. Kanë zbardhuar edhe lugjet e bjeshkëve në kokat e mbështjellura të malsorëve, vargu i të cilëve po derdhet sot në lugun e Besëlidhjes...Sot është e diel, 22 nëntor, 13 fshatra të Rugovës, me afro pesë mijë fshatarë, kanë lidhur qentë me zinxhirë rreth qafe, sepse presin miq. Oxhaqet kanë filluar të hedhin tymin shllunga – shllunga, sapo ka zbardhuar dita. Sot do të lidhet besa më e fortë e këtyre fshatarëve, kundër vëllavrasjes, ngacmimeve, rrahjeve, fejesës së vajzukave pa dëshirë, sikundër ua bën nënave të tyre...”*

Tutje, po japim edhe disa fjali të shkëputura nga folës të këtij tubimi, që kryesisht janë përfaqësues të fshatrave të Rugovës dhe autoriteteve të pushtetit lokal:

Folësi 1: *“...Lidhni besë me besa-besë. Bëhuni miq e bëhuni njerëz. E vllavrasje më s’do t’ketë...”*

Folësi 2: *“Të dashur burra të Rugovës. Tubimi jonë sot për Besëlidhjen kunër hakmarrjes së gjakut në analet e historisë shënon një datë të madhe historike për popullin e Rugovës. Rugova ka pasë, ka dhe do të ketë burra të besës dhe kur ka qenë nevoja e atdheut, kanë ditë me përdor edhe pushkën. Burra të Rugovës, vepra që e bëni ju sot është shumë e madhe...”*

Folësi 3: *“Të përkujtojmë se pasuria ma e madhe ndër shekuj ishte mikpritja, bujaria, dhe ma e madhja është besa shqiptare e trashëgume brez pas brezi, të cilën nuk e ka asnjë popull tjetër në botë që shërben si arma ma e fortë. Edhe pse rugovasi jetuen të izoluem në këtë trevë shkambore në formë të formacionit klanor u dalluen për nga këthjelltësia e mendjes dhe zgjuarsia e pazavendsueme. Ditën me e zgjedh çdo problem...”*

Nga të tri fragmentet e mësipërme, vërejmë se folësi 3 (*më i vejtri në moshë*), bën shmangie ortoepike nga standardi gjuhësor dhe anon më shumë kah varianti i të folmes lokale të asaj krahine, ndërsa dy folësit e parë, si dhe Narratori, përkatësisht autori i kronikës, bëjnë përpjekje të theksuar, që të përdorin një standard gjuhësor, që i përafrohet atij që është miratuar në Kongresin e Drejtshkrimit, dy vjet më vonë, pas realizimit të kronikës. Dy nga folësit, në reportazhin televiziv të sipërpërmendur, duket se nuk kanë shkollim superior, pra, e folmja e tyre është autentike për vendin dhe kohën.

Reportazhi i dytë, në kuadër të këtij shembulli krahasimtar, është për qytetin e Kaçanikut, që është realizuar dhe transmetuar në Televizionin Publik të Kosovës (RTK), në shkurt të vitit 2019. Ende pa hyrë në përmbajtje të reportazhit, qysh në hyrje të titullit të tij, vërehet një gabim i madh gjuhësor, sepse nuk është shkruar drejt emri i qytetit. Pra, titulli i reportazhit është “Reportazh **Kaçaniku**” ndërsa me rregulla, emri i këtij qyteti, shkruhet **Kaçaniku**. Ndërsa, në gjuhën e folur të këtij gazetari, te po ky emër, vërehet një shqiptim i drejtë, duke qenë, se në Kosovë, bashkëtingëllorja palatale *q*, na realizohet në afrikate.

Autori i reportazhit, përkatësisht narratori, lexon tekstin hyrës, me disa shmangie gjuhësore, në fushën fonetike:

NARRATORI: *“Kaçaniku ë:sht qytet i vogël në jug të Kosovës me një sipërfaqe prej treqin e gjasht kilometër katrorë. Rruga, që të dërgon në Kaçanik tani nga kryeqyteti ë:sht magjistranja e vjetër në drejtim të Shkupit. Ndërsa, tani mund të shkohet edhe përmes autostradës së re Arbër Xhaferi, e cila është duke u ndërtuar dhe përshkon përmes qytetit të Kaçanikut. Nëpër këtë qytet kalon edhe hekurudha Selanik-Fushë-Kosovë e ndërtuar në vitin njëmij e tetqind e shtatdhjet e nëntë. Kaçaniku dallohet me faktin se përmes tij kalojnë dy lumenj, Lepenci dhe Nerdimja, të cilat në fund të qytetit bashkohen”.*

Nga ky reportazh, kemi shkëputur thekse nga bashkëbisedimi i autorit me përfaqësues komunalë dhe banorë të qytetit. *Folësi 1*, në këtë shembull, është zyrtar komunal.

Folësi 1: *Çkado që bajmë për bashkatdhetarët tanë osht pak. Dhe kjo osht mund t'jap një përgjigje relative, un mendoj që **bajmë** diçka po aq sa duhet sigurisht që jo. **Saktsisht** po filloj prej asaj që të paktën **bajmë** disa mbishkrime n'qytet që t'paktën me ditë që kemi diçka t're prej 1 korrikut i qesim mbishkrimet për **mirseardhje** t'bashkatdhetarve, **mobilizo:jm** stafin që merret me dokumentacione që ata t'paktën mos t'presin për punë. Merremi vesh me policinë që t'paktën t'rrisim numrin e parkingjeve që ata t'mos **vujn** edhe për veturën ku me **lënë**."*

Ndërsa, *folësi 2*, në këtë shembull, është përzgjedhur një banor i fshatit Strazhë, që flet për natyrën dhe bukurinë e këtij fshati, si destinacion turistik:

Folësi 2: *Zakonisht në këto hapësira verës organizohen edhe pritje për mërgimtarët. Aktivitetet organizohen nga Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, natyrisht nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës z.Besim Ilazi. **Pjesmarrja osht** relativisht e **mi:r**, ndërsa nevojitet që t'krijohen kushte edhe **ma** t'mira që ata të joshen edhe **ma** tepër **n'mnyrë** që të dalin ta **shijo:jn** natyrën edhe k'kto bukuri që **ekzisto:jn n'kto hapsira**.*

Pra, në të dy shembujt e mësipërm, të reportazheve, dëshmohet qartë, se si para pesëdhjetë vjetësh është bërë përpjekje për përvetësimin e normës ortoepike, në kronikat dhe reportazhet në televizionin e vetëm shqip të asaj kohe. Megjithatë, ilustrimi me shembuj të tjerë krahasimtarë, dëshmon se kjo përpjekje, për përvetësimin e gjuhës standarde shqipe, në vend të afirmimit dhe zhvillimit të saj, ka marrë kahje të kundërt të degradimit dhe mosrespektimit, jo vetëm nga folësit në situata të veçanta të ligjërit joformal, por edhe nga vetë folësit në TV, duke përfshirë këtu edhe autorët e kronikave, reportazheve, por edhe vetë drejtuesit e emisioneve, veçanërisht edhe atyre të drejtpërdrejta.